

ty është çlirimi prej lakmisë dhe frikës. Kur lirohesh nga ato, është lehtë për ty të jesh në anën e All-llahut dhe Pejgamberit të Tij. Do të jesh gjithmonë në atë anë në të cilën është All-llahu dhe i Dërguari i Tij. Mirëpo, kur tek ti mbizotëron lakmia dhe frika, mos e dëshiro këtë çështje dhe as mos i fol vetes për te.

Nëse thua: Me çka mund të ndihmohem për t'u liruar nga lakmia dhe frika?

Them: Me Tevhid, me mbë shtetje te All-llahu, me siguri në All-llahun dhe duke e ditur se të mirat vijnë vetëm nga Ai. Vetëm Ai i largon të këqiat dhe se çështjet i takojnë vetëm Atij dhe askujt tjetër.

Redaktura gjuhësore: Klubi Studentor


Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com



Ji me All-llahun dhe mos u brengos!

Autor: Ibn Kajjim el-Xhevzi



-Largohu nga muzika, sepse nuk bashkohen në zemrën e një individi dashuria ndaj muzikës dhe dashuria ndaj Kur'anit. Andaj, vepro me mençuri dhe zgjedhe atë që të bën të lumtur në të dy botërat (dashurinë ndaj Kur'anit).

-Mundohu të largohesh nga shikimet e ndaluara, sepse kjo është nga adhurimet e të devotshmëve.
-Ndhimjoju vëllezërve kur kanë nevojë, sepse kush i ndihmon vëllait të vet kur ai ka nevojë, All-llahu do t'i ndihmojë atij kur të ketë nevojë.

Atëherë, përvjel krahët, filloja punës më me sinqeritet!
Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave!

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com



Kthehu në fenë tënde!

Në qoftë se All-llahu dhe i Dërguari i Tij janë në një anë, mos qëndro në anën tjetër, sepse kjo të shpie deri të kundërshtimi. Mos e zhvlerëso këtë, sepse fillimi të tërheq deri te fundi, kurse e pakta të thërret për të e shumta!

Qëndro në atë anë në të cilën gjindet All-llahu dhe i Dërguari i Tij edhe në qoftë se të gjithë njerëzit janë në anën tjetër, sepse për këtë anë është përfundimi më i falënderuar dhe më i mirë. S'ka për robin diç më të vlefshme se kjo, në këtë botë para botës tjetër.

Shumica e krijesave qëndrojnë në anën tjetër, veçanërisht kur ngjallen dëshirat dhe frika. Atje rrallë gjen ndonjë të qëndrojnë në atë anë në të cilën është All-llahu dhe i Dërguari i Tij, bile ndoshta e konsiderojnë prej mendjelehtëve ose prej atyre që bënë zgjedhje të keqe për vetveten, e ndoshta e adresojnë edhe të budallenjtë, e që kjo është ajo që e trashëguan prej armiqëve të Pejgamberëve. I quajnë budallenj, sepse ata qëndronin në një anë, kurse njerëzit në anën tjetër.

Ai që e ka rregulluar veten në këtë (të jetë në atë anë) ka nevojë për njohje të mirë të Sunnetit të Pejgamberit, që ai të jetë përforcim për të dhe të mos ketë dyshime. Po ashtu ka nevojë për durim të plotë ndaj armiqësive të armiqëve dhe qortimeve të qortuesve, dhe kjo nuk mund të arrihet vetëm se me

deshirë të fortë dhe ambicie të larta për All-llahun dhe Botën Tjetër. Bota tjetër të jetë më e dashur dhe më e çmuar për të se kjo botë dhe që All-llahu dhe Pejgamberi të jenë më të dashur për të se çdokush tjetër.

Për fillimin s'ka diç më të vështirë për njeriun, sepse vetvetja, epshet, natyrshmëria e tij, shejtani, vëllezërit dhe familja e tij e ftojnë për tek e shpejta (që është kaluese) dhe nëse i kundërshton, ata i shpallin luftë, mirëpo nëse tregon durim dhe qëndrueshmëri, vie ndihma e All-llahut e cila e bën të vështirën të lehtë dhe dhimbjen kënaqësi. All-llahu është falënderues dhe patjeter do t'ia shijojë kënaqësinë për anësinë me All-llahun dhe Pejgamberin e Tij dhe t'ia përjetësojë nderin për këtë. I shtohet gëzimi dhe lumturia. I kënaqet zemra dhe kështu triumfon me fuqinë e tij, lumturinë dhe gëzimin. Ndërsa atyre që i shpallën luftë, dikujt i hy frika, dikush dorëzohet dhe dikush e ndihmon e dikush edhe e lë. Kështu forcohet ushtria e tij dhe dobësohet ushtria e armikut.

Mos i konsidero si të vështira kundërshtimet e njerëve dhe anësinë të All-llahu dhe i Dërguari i Tij edhe në qoftë se je vetëm, sepse vërtetë All-llahu është me ty. Ti je me Syrin e Tij, në ruajtjen dhe mbrojtjen e Tij. Ai vetëm e ka sprovuar bindjen dhe durimin tënd.

Pas ndihmës së All-llahut, ndihmuesi më i madh për

selem] dhe shokëve të tij, me shpresë se do të cilësohesh me disa nga cilësitë e tyre.

Vëlla i nderuar!

-Mundohu të jesh i rregullt në ligjëratat të diturisë (sidomos ligjëratat rreth fesë Islame, e sidomos sot kur ne kemi nevojë të madhe për këto mësim, që ta njohim Krijuesin tonë, Zotëruenin, Shpëtuesin, Ndihmësin, Furnizuesin dhe Shpirt-marrësin tone). Thotë i Dërguari i All-llahut, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: „*Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman dhe muslimane*”. (Sahih)

-Bëhu modest, mjer mendje mëdhenjtë, sepse ata nuk do të hyjnë në Xhennet!

-Largohu nga zilia, sepse ky është shkak që All-llahu [subhanehu ve tealala] e largoi Iblisin (djallin) nga Parajsa.

-Respekto prindërit dhe mos i hidhëro, sepse mosrespektuesi i prindërve nuk hyn në Xhennet.

-Vizita e të sëmurëve, bartja e të vdekurve (xhenazeve) dhe vizita e varreve (në mënyrë të lejuar, e jo siç bëjnë disa njerëz, të cilat me një vizitë varresh bëjnë kush e di sa shirke, duke shkuar te varri i ndonjë personi, duke kërkuar nga ai ndihmë, shërim, fëmijë, pasuri ose edhe gjëra të tjera, ngase ai që i kryen këto veprime dhe mendon se i vdekuri mund t'ia plotësojë këto kërkesa, ai është larguar nga Islami dhe është bërë nga jobsimitarët, edhepse pohon se ai është musliman, sepse me kryerjen e këtyrë veprave ai del nga Islami, nëse i është bërë e qartë se veprimi i tillë është i ndaluar dhe e ka kuptuar atë) të bëhet shkak për shtimin e besimit dhe kujtimin e Ditës së Fundit (Ditës së Kijametit). Atëherë, mos përto!

Vëlla i dashur!

-Buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd është sadaka (lëmoshë); shpesh të takimet dhe përmirëso raportet me vëllezërit tu!

Vëlla!

-Dije se jeta yte është pasuri e ytja. Mos e shfrytëzo në atë që nuk ke dobi (të dunjasë dhe ahiretit).

-Zgjedhja e shoqërisë: Mundohu që për shok të kesh atë që kur të bësh vepra të këqia, të këshillon, ndërsa largohu nga ajo shoqëri që e humb kohën kot.

-Kujdesu për namazin, sepse ai është shkak për shpëtim, dhe mos flej në kohën e namazit të sabahut.

"O lënësi i namazit! Me të vërtetë namazi ankohet dhe thotë në kohën e tij:

All-llahu i mallkoftë lënësit e tij!"

-Merr abdes në mënyrën më të pëlqyer, shpesh hapa për në xhami dhe prite namazin pas namazit.

-Shpejto për në xhami posa ta dëgjosh ezanin, sepse All-llahu është më i Madh dhe më i Fuqishëm se çdo send.

-Agjëro më tepër, sepse agjërimi është ilaç për sëmundjet rinore.

-Mësohu që t'u japësh dhurata, ndihma të varfërve, jetimëve, të japësh për xhami, për rrugë etj. sepse ajo është shkak që të largon nga shumë fatkeqësi.

-Shpejto në kryerjen e Haxhit dhe mos vono as Umren, sepse çdo Umre është shlyerje mëkatesh mes tyre.

-Bëji vetes tënde një orar për mësimin e Kur'anit për çdo ditë dhe kujdesu për të, sepse siç thotë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: „*Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve*”. (Buhariu)

-Përkujtoje sa më shumë All-llahun [subhanehu ve tealala], bën d'ua (lutu) ditë e natë, sepse All-llahu u përgjigjet atyre që e përkujtojnë Atë dhe i përgjigjet lutjes së lutësit, nëse bëhet me sinqeritet.

-Lexo/studio historinë e Muha mmedit [sal-lall-llahu alejhi ve